# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-428714**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pagat e gjyqtarëve, administrata e Gjykatës së Tiranës nis bojkotin – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/pagat-e-gjyqtareve-administrata-e-gjykates-se-tiranes-nis-bojkotin/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 8 shtator 2026, 16:46:30 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 8 shtator 2026, 08:47:32 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `894d11e745b386f986e5f6c47eb8fffc6f6d7634685d48baadc447cdc18f1e0f` |
| TEKSTI | `272659c0748330218a4bbb291e0ea2a699673f3278f885ced1ca0a8e448333b7` |
| PAMJA | `df0565b5993f15e2ef6bcd738202415bf498f772522a78b8aace55b4ef8d7989` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5596b9abfefcf83f1b7be2b2d5852d4513c4ea3aeba02ab607b9ed5c5afd3bc5` |
| E MËPARSHMJA | `a2f8a1c922f46e64cc015870c4c199184245106779680e6d285e2239e2afd2f5` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5596b9abfefcf83f1b7be2b2d5852d4513c4ea3aeba02ab607b9ed5c5afd3bc5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Administrata dhe sekretarët gjyqësorë në Dhomën Civile të Gjykatës së Tiranës kanë nisur këtë të martë bojkotin e shërbimeve, në shenjë proteste për moskalimin e pagave të reja.

Punonjësit kanë kërkuar sqarime për situatën e krijuar, ndërsa shqetësimi kryesor lidhet me moskalimin e pagave sipas skemës së re të miratuar. Bojkoti ka sjellë bllokimin e shërbimeve në Dhomën Civile të Gjykatës së Tiranës, ndërsa pritet që problematika të diskutohet edhe në nivel drejtuesish.

Në orën 15:00, të gjithë kryetarët e gjykatave do të mblidhen në Gjykatën e Lartë për të diskutuar situatën e krijuar dhe problematikën lidhur me pagat.

Për pagat e reja të magjistratëve është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese, e cila ka theksuar se arsyetimi dhe dispozitivi i vendimit të saj përbëjnë qëndrimin zyrtar dhe duhet të zbatohen në tërësinë e tyre. Gjykata ka rikujtuar se vendimet e saj janë përfundimtare dhe të detyrueshme për zbatim.

**Redaksia Web**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.
Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh





5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER
**Përmbledhja e ditës në e-mail**
emaili juaj
Abonohu


VENDI

**Nis shkolla, Kumbaro prezanton risitë në...**

Xhuljana Zhuleku · 9 minuta më parë

VENDI

**Nis sezoni i ri shkollor, 680 nxënës më pak...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë

VENDI

**Viti i ri shkollor/ Ministrja Kumbaro...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

● LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale

© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara

vizionplus.tv · Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.